

### Paragrafi III - Organet drejtuese dhe kuadrot drejtuese.

1. Do të jetë një komitet ekzekutiv përgjegjës për të përcaktuar vijën dhe aktivitetet e organizatës. Komiteti do të përbëhet nga bashkësitë e dy përfaqësuesve nga secila shoqëri pjesë-marëse.
2. Komiteti ekzekutiv do të mbledhet të paktën sdo 2 ujet, normalisht 2 ujet përpara Kongresit Evropian të Neurokirurgjisë dhe në lidhje me kongresin.
3. Prezenca e të paktën gjysmës së anëtarëve të komitetit ekzekutiv duhet të jetë e nevojshme për udhëheqjen e proceseve të punës.
4. Do të jenë kuadrot drejtuese të mëposhtërme të cilët do të përbëjnë këshillin administrativ: Presidenti, presë zëvendës presidentë, sekretari, asistenti i sekretarit, përgjegjësi i thesarit (financieri) dhe asistenti i përgjegjësit të thesarit, dhe të gjithë këta do të jenë anëtarë ex-officio të të gjithë komiteteve. Ata do të zgjidhen në mbledhjen e kongresit, dhe emrat e dy prej kuadrove drejtuese (normalisht, presidenti dhe një prej zëvendës-presidentëve) do të pranohen në komitetin emërues të Federatës Botërore të Shoqërive Neurokirurgjikale, i cili do të emërojë njërin prej tyre për tu zgjedhur nga komiteti ekzekutiv i tyre si zëvendës-president; dytë në këshillin administrativ të Federatës Botërore të Shoqërive Neurokirurgjikale. Ata gjithashtu mund të emërojnë një tjetër kuadër drejtues apo anëtar të komitetit ekzekutiv të organizatës si një prej dy zëvendës-presidentëve me kompetenca të gjera. Në rast se vendi i Presidentit mbetet i lirë, atëherë zëvendës-presidenti më i moshuar ftohet të zërë vendin deri në mbledhjen e ardhëshme të Komitetit ekzekutiv, dhe, kur ftesa nuk pranohet atëherë ky vend i ofrohet zëvendës-presidentëve të tjerë sipas moshës.
5. Presidenti i Bashkimit Evropian të Shoqërive Neurokirurgjikale në fund të afatit të zgjedhjes së tij, mund të zgjidhet si President i Nderi nga Komiteti Ekzekutiv. Ai do të ushrojë si këshilltar në këshillin Administrativ dhe në komitetet e tjera, për një kohë katër vjeçare.
6. Këshilli Administrativ do të ketë mundësi të kooptojë shefin botues të revistës zyrtare dhe asistentin botues në secilin prej komiteteve jo-ekzekutive të organizatës.



7. Këshilli Administrativ do të ndryshohet sdo katër vjet me dy përjashtime a) asistenti i sekretarit dhe asistenti i përgjegjësit të thesarit do të zënë vendin përkatësisht të sekretarit dhe të përgjegjësit të thesarit. b) interesi i organizatës lëshoi që një malisim prej dy zëvendës-Prezidentësh të qëndrojnë në detyrë për një periudhë prej kushtesh. Të dy përjashtimet duhet të qyruohen prej dy të tretave të votave të Komitetit Ekzekutiv.
8. Vendqëndrimi i organeve drejtuese do të përcaktohet nga vendqëndrimi i sekretarit të Këshillit Administrativ.
9. Një Komitet formimi i përbërë prej të paktën 5 anëtarëve duhet të caktohet në kohën e sdo Kongresi Europian, dhe të shërbejë për një periudhë prej katër vjetësh. Qëllimi i tij përcaktohet në paragrafin II, N. 5 dhe 7. Kryetari i këtij komiteti duhet të jetë një ex-officio ~~anëtar~~ anëtar i Komitetit të Programimit.
10. Një komitet për Administrimin Mjekësor dhe standardet Neuro-kirurgjikale duhet të caktohet në kohën e sdo kongresi Europian që të shërbejë për një periudhë katër vjetësh.
11. Një komitet për studime korelative duhet të caktohet në kohën e sdo kongresi Europian që të shërbejë për një periudhë katër vjetësh.
12. Një komitet ndërlidhëse duhet të caktohet për të koordinuar proceset lërkimore e të zhvillimit. Komiteti duhet të përbëhet nga dy delegatë prej sdo shoqërie anëtare, ndërsa kryetari i tij duhet të zgjidhet nga komiteti ekzekutiv dhe duhet të jetë anëtar ex-officio i Komitetit të Programimit.
13. Këshilli administrativ duhet të zgjedhë Komitetin e Programimit të paktën tre vjet përpara kongresit të ardhshëm, anëtarë ex-officio të të cilit duhet të jenë kryetari i Komitetit të formimit dhe të ndërlidhjes.
14. Propozimet për ~~anëtarë~~ kuadro drejtues dhe anëtarë të komiteteve duhet të dërgohen me shkrim presidentit në sdo kohë përpara kongresit, ose ato mund të bëhen gjatë mbledhjeve të Komitetit ekzekutiv në kohën e zhvillimit të kongresit. Në rast se nuk ka asnjë propozim nga delegatët, atëherë Këshilli ~~administrativ~~ administrativ duhet të ja bëjë vetë ato Komitetit ekzekutiv.



## Paragrafi IV - Anëtarësia

1. E drejta e anëtarësisë në organizatë përcaktohet nga fakti nëse shoqëria neurokirurgjike në fjalë bëu pjesë apo jo në kufijtë geografikë të Europës ~~Europës~~. Në rastet të veçanta merret vendim nga më shumë se dy të tretat e Komitetit Ekzekutiv.
2. Një shoqëri neurokirurgjike e cila kërkon të pranohet në organizatë, duhet të paraqitë kërkesën së bashku me një kopje të kushtetutës së saj dhe listën e anëtarëve.
3. Çdo grup i përgjithshëm neurokirurgjikal apo shoqëri jashtë Europës mund të bëjë pjesë në organizatë dhe të përfaqësohet në Komitetin e Ndërkohjeve me nga dy delegatë, të cilët mund të kooptohen në Komitetet e tjera jo-ekzekutive.
4. Shoqëritë speciale Europiane, nëngrupet dhe klubet e ndryshme mjekësore të cilat kanë interes në fushën e neurokirurgjisë dhe anëtarësia e të cilave nuk është nevoja të jetë vetëm e profilit neurokirurgjikal, — mund të kërkojnë të pranohen në organizatë dhe nëqoftëse zgjidhen do të përfaqësohen nëpërmjet Komitetit të Ndërkohjeve siç përshtrohet në n. 3 e mësipërm.
5. Anëtarësia në organizatë duhet të vendoset nga më se dy të tretat e Komitetit Ekzekutiv.
6. Me propozim të Këshillit Administrativ, neurokirurgët e shquar të cilët janë tërhequr nga aktiviteti praktik mund të zgjidhen si anëtarë nderi me votë unanime nga Komiteti Ekzekutiv në sheujë mirënjohjeje për kontributin e tyre në fushën e neurokirurgjisë Europiane.

## Paragrafi V - Fondet

1. Fondet e organizatës do të përbëhen dhe rrypërtërihen prej kuotave të mbledhura nga shoqëritë anëtare dhe nga dhuratat apo fondet e marra nga burime të ndryshme (qeveri, universitete, institucione, firma tregëtare apo industriale etj.)
2. Shuma e kuotës së paguar nga shoqëritë anëtare do të përcaktohet nga Komiteti Ekzekutiv.